



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaçica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. Dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2559
Dt 29.11.2019

VENDIM

- I. Dr. sc. Albulena Grajqevci, asistente në Fakultetin e Edukimit, emërohet koordinatore qendrore për bashkëpunim ndërkombëtar e UMIB-it, duke filluar nga data 2.12.2019.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit qendror për bashkëpunim ndërkombëtar janë:
 - Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për implementimin e programeve studimore me partneritet ndërkombëtar si, identifikimi i partnerëve ndërkombëtar për bashkëpunim, lidhjen e marrëveshjeve për mobilitet, promovimi i programeve jashtë vendit etj.
 - Kryen aktivitete në arritjen e partneritetit ndërkombëtar, duke promovuar dhe avancuar bashkëpunimin me partnerët ekzistues si dhe hulumtuar mundësit për anëtarësim në shoqata të ndryshme ndërkombëtare
 - Organizon prezantime dhe punëtori nëpër fakultete me qëllim njoftimi dhe trajnimi për të aplikuar në projekte (të përbashkëta) ndërkombëtare
 - Identifikon, informon dhe përkrah Fakultetet/studentët për shfrytëzimin e mbështetjeve të ndryshme (bursa, etj) nga partnerët ndërkombëtar.
 - Informon Fakultetet për thirrjet e programeve për shkëmbim të studentëve, si Erasmus+, etj.
 - Komunikon me fakultetet në lidhje me procedurat për mobilitet të studentëve dhe stafit akademik, dhe siguron mbështetje për studentët dhe stafin akademik para, gjatë dhe në kthim nga qëndrimi jashtë vendit në kuadër të mobilitetit.
 - Në bashkëpunim me menaxhmentin e UMIB-it, përkatësisht me prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe me akterët e tjerë relevantë përkrah promovimin dhe zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Rregullorja për ndërkombëtarizim dhe mobilitet.
 - Nën udhëheqjen e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar, menaxhon me zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar.
- III. Të përmendurës i takon kompensimi për ushtrimin e detyrës së koordinatorit qendror për zhvillim akademik në bazë të Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurës;
3. Zyrës së personelit;
4. Shërbimit financiar.



Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it